



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 02.05.2023, të parashtruar nga Grupi Operatorëve Ekonomik "STONE GROUP" Shpk & "BASHKIMI METI" shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Kodra e Sukës-Cërmjan", Nr. i prokurimit- 632-23-1715-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-014 -521, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi Operatorëve Ekonomik "STONE GROUP" Shpk & "BASHKIMI METI" shpk, e dt.02.05.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Kodra e Sukës-Cërmjan", Nr. i prokurimit- 632-23-1715-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-014 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.04.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 24.04.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.02.05.2023, Grupi Operatorëve Ekonomik "STONE GROUP" Shpk & "BASHKIMI METI" shpk,, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Kodra e Sukës-Cërmjan", Nr. i prokurimit- 632-23-1715-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-014 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.05.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë, është i pa bazuar sepse kriter i dhënjes ka qenë çmimi ekonomikisht më i favorshëm e jo çmimi më i lirë siç pretendoni ju:

Kriteret e Dhënies	30.1	[Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshtës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6] <input checked="" type="checkbox"/>
--------------------	------	---

Pretendimi juaj i dytë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional nuk qëndron sepse OE "REA" sh.p.k., ka paraqitur listën e kontratave të kryera .

KLINË, Rruga Lidhja e Pejës  
Tel : 044 500 478  
NRB i shitesit: 81242502

**REA**  
Sh.P.K.

Projektet e perfunduara gjate 3 viteve të fundit

Emri i projektit	Vlera e projektit	Data e kontraktimit	Data e përfundimit të kontratës	Autoriteti kontraktues	Pranimi teknik
Asfaltimi i rruges Perqevë-Sierke faza e dyte	145,414.70 €	28.06.2019	20.07.2020	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Asfaltimi i rruges Kruz-Masor	289,634.42 €	22.11.2019	15.10.2020	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Asfaltimi i rruges që lidhe ishizat Rud-Sierke	267,270.00 €	18.09.2019	23.10.2020	Kuvendi Komuna Malishevë	Po
Asfaltimi i rruges Qupeve	92,605.80 €	09.09.2020	07.12.2020	Kuvendi Komunal Klinë	Po
montaksore në Glareve ,Rëchieve e Stapanic	107,574.67 €	04.11.2020	30.06.2021	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Pune shtese ne projektin -Asfaltimi i rruges Glareve-Rëchieve Stapanice	9,656.00 €	19.05.2021	30.06.2021	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Asfaltimi i rruges Perqevë	89,000.00 €	09.06.2021	06.08.2021	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Pune shtese-Asfaltimi i rruges Perqevë	4,096.09 €	13.12.2021	06.08.2021	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Asfaltimi i rruges Gorozhdec-Belince	234,030.00 €	10.09.2020	17.06.2021	Komuna Pejt	Po
ndertimi i rruges dhe trotuarit Voljajak-Sierk	163,000.00 €	22.07.2022	14.10.2022	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Montaxori i rruges dhe infrastrukures neontaksore ne Zajmi Dëiq	61,205.00 €	14.07.2022	17.10.2022	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Asfaltimi i rruges dhe infrastrukures Lot-1	79,850.00 €	09.08.2022	08.11.2022	Kuvendi Komunal Klinë	Po
Asfaltimi i rruges lokale Caravik-Qabiq					

Rehabilitimi i pikt te stacionit transfer dhe pjeses para stacionit ne legjen Ali Ibra „Komuna Gjakove	208,000.45 €	28.10.2022	21.12.2022	MMPHI	Po
Asfaltimi i rrugeve ne fshatrat e Komunes se Pobjese -Pjesa II	395,000.00 €	30.08.2021	20.12.2022	Komuna Pobje	
<b>Totali</b>	<b>2,146,398.13 €</b>				



Pretendimi juaj i tretë gjithashtu nuk qëndron, sepse operatori ekonomik i shpallur fitues, ka paraqitur listën e pajisjeve të cilës i ka bashkangjitur librezat të regjistrimit të automjeteve për kamiona, dudu doganor / fatura për eskavator , finishera, grider dhe cilindra.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës